



# BULETINI

Për Shoqërinë Civile të Qarkut të Elbasanit

Numri 1

## Një ditë si gjithë të tjerat

Në rrugën pranë gjykatës u bllokua trafiku dhe makinat për disa minuta ia lanë hapësirën e tyre disa njerëzve të veçantë që me nga një shkop të bardhë tërhoqën vëmendjen e kalimtarëve. Është 15 tetor, dita e shkopit të bardhë dhe anëtarë të shoqatës së verbërve të degës Elbasan bënë një parakalim simbolik në përkujtim të kësaj dite për të kremtuar guximin dhe kurajon për të shmangur izolimin dhe plogëshinë.

Historia e kësaj dite ka filluar me fotografimin Leon George në vitin 1930, i cili pasi humbi shikimin përdori një shkop të dallueshëm që njerëzit të vënin verbërinë e tij ndërsa ai dilte në rrugë. Lion Club International promovoi përdorimin e shkopit të bardhë që tani është një simbol i verbërisë. Shkopi që ka një shirit të kuq në majë, është i bardhë që ta bëjë të dallueshëm ekzistencën e vet në sfondet e errëta të rrugëve. Shkopi e mbron mbajtësin e tij nga aksidente për ti imponuar kujdes personave dhe automjeteve rreth e qark.

Po pse nuk përdoret shkopi i bardhë në Shqipëri? Sistemi që kaloi la një shije moskonsiderimi nga shoqëria të personave me aftësi të kufizuar përfshi të verbërit.

Ata duan të integrohen në shoqëri dhe për këtë është e nevojshme lëvizja. Imagjino një qytetar të verbër vetëm me shkopin e tij

nëpër rrugët e qytetit.

Çfarë do bëjë ai kur duhet të kalojë rrugët, kryqëzimet?

Me kushtet që ekzistojnë duke përfshirë dhe sistemin e rrugëve dhe sinjalizimit nëpër kryqëzime të verbërit mund të lëvizin vetëm me shoqërues, gjë që nuk është gjithmonë e mundur.

Një sfidë e vërtetë për komunitetin e të verbërve që në Shqipëri është iniciativa e vet të verbërve për të thyer paragjykimet dhe për ta parë vetveten si qytetarë me të drejta të barabarta. Ata nuk janë duke kërkuar mëshirë nga shoqëria por mundësi dhe mbështetje, sepse ata e shikojnë veten të aftë për tu përfshirë dhe integruar në jetën shoqërore, dhe për të treguar se çfarë mund të bëjnë.

Të verbërit si një komunitet i lënë pas dore përgjatë viteve nga institucionet dhe shoqëria janë bashkuar rreth shoqatës së tyre për të reaguar ndaj paragjyqimit dhe moskonsiderimit nga shoqëria normale. Ata dëshirojnë ta jetojnë jetën si gjithë të tjerët.

**Gazmend Karakyzja**

**Kryetar i Shoqatës së Verbërve Elbasan**



### **Çfarë është 3 dhjetori!**

Viti 1993 është viti kur 3 dhjetori është shpallur botërisht si dita ndërkombëtare sensibilizuese për mbrojtjen e të drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (PAK).

Që nga ky vit e ka zanafillën edhe në qytetin tonë 3 dhjetori. Shoqata MDPAKM (Mbrojtje të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar Mendore) është angazhuar që në fillim me problemet e sensibilizimit në fushën e të drejtave të PAK. Në 3 dhjetorin e parë kjo shoqatë sensibilizoi me një veprimtari sensibilizuese me tematikë “Ktheni sytë edhe nga ne” të mbështetur edhe nga Kryqi i Kuq i degës Elbasan. Nga viti në vit janë përdorur sigla të ndryshme si “Jemi edhe ne”, “Të ndryshëm, por të barabartë”, “Përshtatshmëri për të gjithë në milleniumin e ri”, “Teknologji informimi për të gjithë”, “Pjesëmarrje e plotë dhe barazi shansesh”, “Jetesë e pavarur dhe kushte të qëndrueshme jetese” për të ardhur në vitin 2003 që ishte edhe viti evropian i trajtimit të aftësisë së kufizuar, që lancoi siglën “Të aftë ndryshe” ku tërhiqet vëmendja që këta persona të mos trajtohen si persona me aftësi të limituara, por si të aftë e me potenciale të ndryshme nga ata që takojmë në jetën e përditshme.

Në vitin 2004 motoja: “Asgjë për ne, pa ne” kërkoi ndërgjegjësimin për përfshirjen në vendimmarrje të vetë personave me AK.

Të gjitha këto thirrje kanë qenë botërore dhe në unison me kartat dhe deklaratat e OKB për zbatimin dhe zhvillimin e politikave sociale.

Në këto 3 dhjetore MDPAKM ka organizuar “Dita informacion”. Për këtë qëllim janë shpërndarë postera, literaturë që lidhet me AK dhe me parandalimin e hershëm të saj, me mundësitë për rehabilitim etj. MDPAKM ka qenë edhe pjesë e diskutimeve që çuan në hartimin e strategjisë kombëtare për PAK.

Motoja e këtij 3 dhjetori ishte:

**“Të drejtat e PAK, aksion në zhvillim”.**



**Manifestimi sensibilizues-3 dhjetor 2005**

Për këtë qëllim pati një bashkëpunim shumë të mirë të të gjitha shoqatave e institucioneve që punojnë në fushën e AK në qarkun e Elbasanit ku promotore ishte MEDPAK Librazhd mbështetur nga World Vision, MDPAKM Elbasan, Shoqata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve, Shoqata e të Verbërve, Shoqata e Invalidëve të Punës, shkolla speciale “Zëra jete”, etj. Ky 3 dhjetor manifestoi një shkallë më të lartë ndërgjegjësimi për vetë shoqatat që veprojnë në fushën e AK. Kështu personat me AK të drejtuar nga shoqatat ku bëjnë pjesë me parrulla ku kishin shpallur të drejtat e tyre bënë një manifestim sensibilizues për të drejtat e tyre në mjediset e hapura përpara Prefekturës së Elbasanit. Përfaqësuesja e MEDPAK Librazhd znj.Zela Koka me megafon u rikujtoi përfaqësuesve të pushtetit vendor se duhet të jenë më të ndjeshëm e me të disponueshëm për zbatimin e ligjshmërisë për plotësimin e nevojave të PAK, si për përshtatjen e mjediseve urbane, për integrimin e tyre social përmes punësimit, shkollimit, përmirësimit të kushteve të jetës, pjesëmarrjes në vendimmarrje për probleme që lidhen me ata etj. Këtij 3 dhjetori iu bashkua edhe një program televiziv në studion e ETV ku përfaqësues të shoqatave të ndryshme të AK debatuan për probleme të ndryshme të PAK që kërkojnë zgjidhje sot në realitetin e ashpër shqiptar. Në mjediset e shtëpise së kulturës u dha një koncert

sensibilizues titulluar “Na dëgjoni edhe ne” nga nxënës të shkollës speciale “Zëra jete”, dhe nga nxënës të komunave Shirgjan dhe Shtërmën me AK por të integruar dhe ndihmuar nga World Vision. Shpresojmë që këto veprimtari të kenë lënë gjurmë në

komunitetin elbasanas që shquhet për frymën e solidaritetit e të tolerancës.

**Engjëllushe Bejtja**

**Kryetare e Shoqatës MDPAKM -Elbasan**

\*\*\*\*\*

### **Stampime dhe punime me thupër...**



...janë artikujt, që të rinj kryesisht me aftësi të kufizuar, realizojnë në “ndërmarrjen” e tyre sociale “Fllad”. Nuk janë artikuj çfarëdo! Janë prodhuar nga vetë të rinjtë. Është munda i tyre gati tre vjeçar, i cili materializohet çdo ditë e përpiqet të sensibilizojë shoqërinë ku jetojmë, për ekzistencën e tyre. Tashmë, për këta të rinj, ky aktivitet është kthyer në pjesën më të rëndësishme të jetës.

Puna u ka dhënë kuptim ditëve të tyre, u ka dhënë qetësinë që u ka munguar, u ka kthyer gëzimin dhe interesin për gjithçka. Nuk janë artikuj çfarëdo, pasi bartin me vete një sërë vlerash e të drejtash njerëzore. Në këto produkte ata kanë vënë pasionin, punën dhe dinjitetin. Në emër të këtyre vlerave, këto produkte përpiqen të mbijetojnë e të hyjnë në çdo ambient, që tregon sadopak interes. Ato bëhen vetvetiu dëshmitare të një realiteti, që sa vjen e rritet dhe nuk do të jetë larg momenti kur ky i fundit të jetë përkrah çdo realiteti tjetër shqiptar. Janë çelësi për tu integruar në shoqëri, janë argumenti i tyre më i fortë për tu përballur me të.

**Mirela Salla**

**Fllad**

\*\*\*\*\*

## **PROFIL ORGANIZATE**

### **MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA (MEDPAK)**

MEDPAK është një shoqatë jofitimprurëse e krijuar në vitin 1993, nga prindër me fëmijë me aftësi të kufizuar në qytetin e Librazhdit, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të tyre.

**Vizioni :**Të barabartë në të drejta, të ndryshëm në nevoja.

**Misioni:** MEDPAK punon për mbrojtjen e të drejtave të personave me Aftësi të

Kufizuar (AK), përmes njohjes dhe zbatimit të akteve ligjore e nënligjore, trajnimit të anëtarëve e më gjerë, sensibilizimit të komunitetit për të kërkuar zbatimin e të drejtave, lobimit për miratimin dhe zbatimin e ligjeve, krijimin e shërbimeve, me qëllim që të arrihet një jetë dinjitoze për të gjithë.

**Nëpër vite**

Në vitin 1994 u hap një qendër ditore për fëmijët me AK në qytetin e Librazhdit.

Në vitin 1996 fillimisht u trajnuan disa mësues për arsimin special të integruar.

Në Shtator 1996 u hap një klasë e edukimit special të integruar për fëmijët me AK në shkollën tetëvjeçare "Genc Leka" Librazhd.

Në Tetor 1998, 20 mësues nga rrethi i Librazhdit u trajnuan për arsimin special nga shoqata "Children's Aid Direct".

Në Shtator te vitit 1999 në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Librazhd dhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës u hap edhe një klasë të edukimit special për fëmijët me AK në qytetin e Prrenjasit.

Në vitin 2000 u bë studimi dhe u vlerësuan nevojat për gjithë njerëzit me AK në rrethin e Librazhdit. Pas këtij studimi në Shtator 2000-2003 me fonde të UNICEF filloi arsimimi i fëmijëve me AK duke i integruar ata në shkollat pranë vendbanimit të tyre në gjithë rajonin e Elbasanit, rreth 315 fëmijë të moshës 6-10 vjeç.

Në Dhjetor të 2002 në qytetin e Librazhdit, në partneritet me Bashkinë Librazhd dhe shoqatën "Save the Children Shqipëri", për edukimin e fëmijëve me AK të rënduar u hap një qendër ditore, e cila frekuentohet nga fëmijë me AK të rënduar të qytetit të Librazhdit dhe 2-3 fëmijë nga qyteti i Elbasanit.

Me hapjen edhe të kësaj qëndre ne si shoqatë kemi zbatuar të drejtën për arsim për fëmijët me AK dhe integrimin e tyre në komunitet.

Në vitin 2003 shoqata hapi një Qendër Burimore për AK në qytetin Librazhd, e cila krijon lehtësi për prindërit në rajonin e Elbasanit.

Në vitin 2004 u realizua projekti: "Vlerësim i nevojave të fëmijëve me AK për një arsim special të integruar në Tiranë". Kjo u zbatua në shërbimin social të Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e Dispozitave Normative duke realizuar integrimin e fëmijëve me AK në shkollat publike të arsimit të detyruar. Githashtu u realizua kthimi i shkollës "Luigj Gurakuqi" në një qendër profesionale, për

aftësimin e adoleshentëve me AK në përshtatje me aftësitë që ata kanë.

Në Dhjetor të 2004 ekspertë të shoqatës realizuan studimin me temë: *Raport studimor mbi "Efektivitetin e Zbatimit të Kuadrit Ligjor që garanton edukimin e fëmijëve me AK në kushtet e arsimit gjithëpërfshirës- përvojë rajonale, arritje, sugjerime dhe sfida për të ardhmen.*



**Stafi i Qendrës Ditore**

Në Dhjetor të 2004 MEDPAK u vlerësua me Çmimin e I-rë nga "Handicap International" në Beograd: "Për shërbimet më të mira me bazë komunitare".

Tashmë shoqata MEDPAK, me përvojën e krijuar, trajnimin e mësueseve për arsimin gjithëpërfshirës, realizimin në praktikë të ligjit shqiptar për periudhën nga viti 1996, e konsideron arritje realizimin e të drejtës për arsimim të personave me AK, të integruar së bashku me bashkëmoshatarët e tyre në komunitetin ku ata jetojnë.

Tani MEDPAK po punon për rreth 700 persona me AK dhe familjet e tyre.

**Adresa:**Lagja:"10 Nëntori",Rr:"Q.Murtini",  
Pallati 13, Librazhd  
**Tel/Fax:** 0514 34 68/ 34 96  
**Cel:** 068 25 78 002/069 22 08 985  
**Email:**medpak@albbmail.com &  
nkoka@albbmail.com

## Të Ndryshëm por të Barabartë



Koncert i fëmijëve me AK -3 dhjetor 2005

Ky projekt i World Vision zbatohet në gjashtë komuna (Bradashesh, Gjergjan, Shirgjan, Gjinar, Shushicë dhe Labinot-Fushë).

Qëllimi është të ndërgjegjësojë prindërit e fëmijëve, komunitetin e organet e pushtetit lokal mbi të drejtat e fëmijëve me AK për edukim e kujdes shëndetsor. Në këtë projekt janë përfshirë 345 fëmijë ku 100 prej tyre janë ndihmuar me vizita mjekësore dhe pajisje.

Krahas fushatave të ndërgjegjësimit janë trajnuar në gjashtë komuna e mësipërme: 150 mësues, 12 punonjës të sektorit të ndihmës ekonomike, 100 prindër, 76 infermjere, 300 gra. Gjithashtu në 5 komuna janë ngritur dhoma rehabilitimi me pajisje bashkëkohore ku fëmijët me AK dhe prindërit e tyre mund të këshillohen dhe ndihmohen.

\*\*\*\*\*

## Qarku i Elbasanit

Meqenëse ky buletin është për gjithë qarkun e Elbasanit menduar t'ju japim një informacion mbi qarkun e Elbasanit i pregatitur nga Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit në Këshillin e Qarkut.

Qarku i Elbasanit ka një sipërfaqe prej 3292 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 434.768 banorë. Kufizohet në veriperëndim me qarkun e Tiranës, në lindje dhe juglindje me qarkun e Korçës dhe në perëndim dhe jugperëndim me qarkun e Beratit.

Qarku është i përbërë nga katër rrethe: Elbasan, Librazhd, Peqin dhe Gramsh.

Qarku përbëhet nga 7 bashki, 43 komuna dhe 386 fshatra.

Kushtetuta e Shqipërisë, neni 110 pika 2, thotë: "Qarku është njësi ku ndërtohen dhe zbatohen politikat rajonale dhe ku ato harmonizohen me politikën shtetërore".

Ligji nr. 8652 dt.31.07.2000, neni 13, pika 1 Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore thotë: "Funksionet e Qarkut janë ndërtimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat shtetërore në nivel Qarku".

Organi përfaqësues i qarkut është Këshilli i Qarkut që përbëhet nga 94 anëtarë-përfaqësues të komunave dhe bashkive.

\*\*\*\*\*

## Faqe interneti mbi aftësinë e kufizuar

Fondacioni Shqiptar për Personat me Aftësi të Kufizuar

Karta për të Drejtat Elektorale për PAK  
SHARE-SEE

Disability Rights Commission

[www.adrf.org.al](http://www.adrf.org.al)

[www.electionaccess.org/rs/Bill\\_Albanian.htm](http://www.electionaccess.org/rs/Bill_Albanian.htm)

[www.share-see.org/albanian](http://www.share-see.org/albanian)

[www.drc-gb.org](http://www.drc-gb.org)